



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Prokurimit



02-Nr 400/01-51911 dt. 08/12/2025

Në mbështetje të nenit 9 të kushteve të përgjithshme të kontratës , nenit 61 pika 29 të Rregullave dhe Udhëzimit Operativ të Prokurimit Publik dhe Rekomandimit të dhëna nga menaxheret e projektit te dates 05.11.2025 me numer te arkives 06/400-01-48409 , Zyra e Prokurimit me datë 06.11.2025 , merr këtë

V E N D I M

- I. I ndërpritet kontrata Operatorit Ekonomik "KATRORI GROUP SH.P.K.: " me nrf 812183416 me pronar Blerina Gashi Deva për tenderin me titull "Furnizimi ne rafta per barnatoren e QMF-Komoran" me numer identifikues 611-25-5350-1-3-6, me nr. te arkivit 02/400-01/44430 i datës 08.10.2025 .
- II. Me gjithë shkresat , vërejtjet dhe rekomandimet e dhëna nga menaxheri i projektit " KATRORI GROUP SH.P.K kontrata me numer 611-25-5350-1-3-6 me nr. te arkivit 02/400-01/44430 i datës 08.10.2025 . eshte nderprere per shkak qe projekti nuk mund te implementohet ne teren per shkak qe sasiste ne paramase nuk perputhen me ato ne teren . Kontrat nderpritete ne bashkpunim me OE I cili eshte pajtuar per nderprerje
- III. Ky vendim për ndërprerjen e kontrtës hynë në fuqi ditën e nënshkrimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit
Gentiana Qela

Vendimi i'u dërgohet:

- Operatorit Ekonomik
- Drejtorisë së Shendetsis ;
- Zyrës së Prokurimit
- Arkivit të Komunës së Drenasit;



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Re: Kerkese

algroup.pro.shpk <algroup.pro.shpk@gmail.com>

Mon 12/1/2025 12:47

To:Valdete B. Ramaj <Valdete.B.Ramaj@rks-gov.net>;

Cc:Liridone I. Durmishi <Liridone.I.Durmishi@rks-gov.net>; Endrit Gllareva <Endrit.Gllareva@rks-gov.net>; Lumnije O. Krap
<Lumnije.O.Krapi@rks-gov.net>; Lumturije Kiqina <Lumturije.Kiqina@rks-gov.net>; Gentiana Qela <Gentiana.Qela@rks-gov.net>;

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Gjithashtu, konfirmojmë se projekti se gabimet e identifikuara janë rezultat i lëshimeve teknike nga ana jonë, të cilat do të korrigjohen në përputhje me procedurat .

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

On Fri, Nov 7, 2025 at 9:51 AM Valdete B. Ramaj <Valdete.B.Ramaj@rks-gov.net> wrote:

I nderuar,

Pas gabimeve teknike që janë paraqitur në projektin "Furnizim me rafta për barnatoren e QMF Komoran" të hartuar dhe projektuar nga ana juaj, kerkoj nga ana juaj që përmes emailit të na njoftoni për gabimet në paramasë, pasi ju jeni përgjegjës për këtë projekt . kur dihet që ky projekt nuk është pranuar dhe as nuk është bërë asnjë pagesë.

Kerkoj nga ana juaj që të na konfirmoni se kto gabime janë gabime nga ana juaj.

Prishtinë Çagllavicë, Swiss Village, nr 7

Mob. +383 49 45 22 22

Te mirren masat
në lidhje me gabimet e identifikuar
në hartimin e parametres dhe
projektit me fletë.
Ramirz Lladrovci
07.11.2025

Kerkese nga Zyra e Prokurimit ne Drenas

Gentiana Qela

Thu 11/6/2025 11:05

Sent Items

To: katorigroup@gmail.com <katorigroup@gmail.com>;

Te nderuar ,

Po ju shkruejme ne lidhje me projektin " Furnizim em rafat per barnatore " me numer te prokurimit 611-25-5350-1-3-6 e kontraktuar me date 08.10.2025 ne mes te KATRORI GROUP SH.P.K.:dhe AK - Komuna e Drenait .

Per shkak te gjendjes ne teren qe nuk perputhet me paramasen sepse sasite nuk pershtaten me teren ka sasi me pak se sa ne teren me paramase .

Ak do te beje korrigjimin e paramases dhe do te ri-tenderoje proceduren .

A pajtoheni me nderperrejn e kontrates dhe nga ana e juaj si OE ?

Me Respekt !

Re: Kerkese nga Zyra e Prokurimit ne Drenas

KATRORI GROUP <katrorigroup@gmail.com>

Thu 11/6/2025 11:09

To: Gentiana Qela <Gentiana.Qela@rks-gov.net>;

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Te nderuar,

Duke e pare gjendjen faktike dhe paramasen te cilat nuk kane perputhshmeri ne Katrori Group Shpk - pajtohemi me nderprejten e kontrates ne menyre miqësore.

Faleminderit

Katrori Group Shpk

On Thu, Nov 6, 2025 at 11:06 Gentiana Qela <Gentiana.Qela@rks-gov.net> wrote:

Te nderuar ,

Po ju shkruajm ne lidhje me projektin " Furnizim em rafat per barnatore " me numer te prokurimit 611-25-5350-1-3-6 e kontraktuar me date 08.10.2025 ne mes te KATRORI GROUP SH.P.K.:dhe AK - Komuna e Drenait .

Per shkak te gjendjes ne teren qe nuk perputhet me paramasen sepse sasi nuk pershtaten me teren ka sasi me pak se sa ne teren me paramase .

Ak do te beje korigjimin e paramases dhe do te ri-tenderoje proceduren .

A pajtoheni me nderprejten e kontrates dhe nga ana e juaj si OE ?

Me Respekt !

 Logo

 Logo

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		05/11/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
06	400/01	48409	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
 Drejtoria për Shendetësi dhe Mirëqenie
 Sociale



Data	05/11/2025
Nga:	Menaxheri i Kontratës Armend Kurtaj
Për:	Zyrën Prokurimit
Lënda:	Raport për ndërprerje të Kontratës me titull "Furnizimi me Rafta për Barnatoren e QMF-Komoran"

Në cilësinë e menaxherit të kontratës për **Furnizimi me rafta për barnatoren e QMF-Komoran**, me nr Nr,400/01-45305 dt 15.10.2025, ju informoj se është konstatuar një mospërputhje e planifikimit punimeve të realizuara në terren nga operatori ekonomik, dhe paramases, dhe skices se kerkuar nga kompania projektuese **AL-GROUP-PRO**

Gjendja aktuale:

- Paramasa e kontratës specifikon (PIKA 2.2) 16 m² rafta për barnatoren, pa ndarje për depo.
- Skica zyrtare nuk ishte pjesë e dosjes së tenderit në kohën e ofertimit.
- Me datë 29.10.2025 pas kërkesës sonë për skicë për orientimin e sakt të zbatimit të punimeve është dërguar një skicë për montim vetëm në depo, e cila nuk korrespondon me përshkrimin e punimeve në paramasë.
- Operatorit i është bërë me dije paraprakisht të mos montojë raftat, deri në sqarim me dokumentacionin projektues.


Vlerësim:

Bazuar në këtë situatë, rezulton se:

- Paramasa është e manget, nuk ka specifika të detajuara të punimeve, për lartësi, gjersi e as thellsi të raftave dhe është jashtë planifikimit.
- Skica është e vonuar dhe e pasaktë

Rekomandim:

Pas marrëveshjes me Operatorin ekonomik **Katrori Group** në cilësinë e menaxherit të kontratës, kërkoj nga zyra prokurimit që të nderpritet kjo kontratë ndërmjet Operatorit Ekonomik dhe Autoritetit Kontraktues, në përputhje me procedurat dhe ligjet në fuqi.






Investitor:				
Projekti:	Renovimi i Barnatores	Studio e arkitektures:		Nr.
		Paraqitja:	Raftat dhe shaniku	2
Lokacioni: Komoran	2025	Faza :	ARKITEKTURA	1:50

PARAMASA DHE PARALOGARIA FURNIZIM ME RAFTA PER BARNATORE QMF KOMORAN

Të gjitha pozicionet përfshijnë , furnizimin me material, punimin dhe vuarja në vepër e të gjitha punëve të parapara. Për të gjitha pozicionet duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, vendosjen, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendjen plotësisht funksionale, garancjonin, testimet si dhe kompletimin e qertifikatave të aseteve të prodhuesëve. Në qmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuerjen në funksjon . para se të bëhet furnizimi dhe porosia masat duhet të mirrën ne vend. Për të gjitha materialet, modelin ngjyren sipas përzgjedhjes se org. Mbikqyrës. Llogaria e sasieve përfundimtare do të bëhet me liber ndertimore pas përfundimit të tersishëm të pozicionit. Të gjitha mbeturinat nga demolimet, materialet e mbetura duhet të transportohen në deponin me të afërt legale.

Nr	Pershkrimi i pozicionit .	Njesia	Sasia	Qmimi	Qmimi me TVSH
PUNËT PERGADITORE					
1.1	Pastrimi i terenit dhe largimi i gjitha mbeturinave deri në deponi.	komplet	1.00	200.00 €	200.00 €
1.2	Pergaditja e punishtës për fillimin e punimeve, verifikimi i pozicioneve punuëse, koordinimi me investitorin.	cope	1.00	100.00 €	100.00 €
1.3	Te gjitha materialet, pajisjet, orenditë, dollapët dhe makineritë duhet të jenë të sistemuara dhe të mbuluara në mënyrë të sigurt deri në përfundimin e projektit. Ato duhet të izolohen në mënyrë të tillë që, pas përfundimit të punimeve, të rikthehen në vendndodhjet e tyre origjinale.	komplet	1.00	200.00 €	200.00 €
Gjithësej Totali 1				500.00 €	
Nr	PUNËT RENOVOUËSE	Njesia	Sasia	Qmimi	Qmimi me TVSH
2.1	Furnizimi me material; pergatitja e dyshemese per epoksid - Gerryerja e betonit me makine me sfera metalike, mbushja e dilatimeve dhe plasaritjeve me llaq epoksid, riparimet e gropezave ventuale etj. Furnizimi dhe shtrirja e primerit (bazës) epoksid ne trashesi 1.0 mm të cilit duhet ti shtohet rërë kuarci me fraksion 0.3-0.8 mm si dhe miell kuarci. Furnizimi dhe mbushja e dyshemesë me rërë kuarci me fraksion 0.3-0.8 derisa dyshemeja është ende në gjendje të lëngët e cila e ngritë nivelin ne min. 1.5 mm. Furnizimi dhe shtrirja e epoksidit me ngjyrë vetenivelizues me ngjyre simbas zgjedhjes se projektuesit me trashesi 2.0 mm si dhe hudhja e fiuskave dekorative (çipsat). Furnizimi dhe shrirja e shtreses mbrojtese (llak transparent) Anti gervishtje e cila duhet te kombinohet me qelq te bluar. Prerja e dilatimeve me makine speciale dhe mbushja e tyre me stuko poliuretani.	m2	3.00	35.00 €	105.00 €
2.2	Furnizimi me material; pergatitja Raftet dhe shnaku do të shërbejnë për ekspozimin dhe organizimin e produkteve farmaceutike në barnatore, duke respektuar standardet e nevojshme për higjienë, rezistencë ndaj lagështisë dhe përbërjeve kimike. Konstruksioni i rafteve do të realizohet nga kombinimi i MDF të laminuar dhe profileve mbështetëse. Materiali kryesor: MDF me densitet të mesëm (minimum 18 mm trashësi), i laminuar në të dyja anët me sipërfaqe melamine antibakteriale me rezistencë ndaj lagështisë dhe kimikateve të zakonshme farmaceutike.	m2	16.00	175.00 €	2,850.00 €
Gjithësej Totali 1				2,955.00 €	
POZICIONET					
PUNËT PERGADITOR					500.00 €
PUNËT RENOVOUËSE					2,955.00 €
GJITHESJ TOTALI ME TVSH				3,455.00 €	



Investitor:		Projekt:		Studio e arkitektures:		Nr.
Komuna e Glogocit		Renovimi i Barnatorës		Paraqija:		
Lokacioni: Komoran		2025		Faza :		1:50
				ARKITEKTURA		

Armend Kurtaj

From: Armend Kurtaj
Sent: Friday, October 24, 2025 3:40 PM
To: 'algroup.pro.shpk@gmail.com'
Cc: Lumturije Kiqina; Lumnije O. Krap; Liridone I. Durmishi; Gentiana Qela
Subject: Kërkesë për skicën e raftave – ne barnatoren e QMF Komoran

I nderuar

Ju lutem, më dërgoni skicën zyrtare për vendosjen e raftave në barnatoren e QMF Komoran, në mënyrë që të kem dokumentin për orientim të saktë gjatë zbatimit të punimeve.

Deri tani nuk kam pranuar asnjë skicë në dokumentacionin që posedoj, prandaj kërkoj që të ma dërgoni me email sa më pare, qe operatori te filloj me punime.

Faleminderit për bashkëpunim.

Armend Kurtaj – Zyrtar për Politika të Banimit

Komuna Drenas

Telefon: +383 044 833 088

Email: Armend.Kurtaj@rks-gov.net

Armend Kurtaj

From: Armend Kurtaj
Sent: Wednesday, October 29, 2025 11:15 AM
To: 'Katrorigroup@gmail.com'
Cc: Lumturije Kiqina; Lumnije O. Krapë; Gentiana Qela; Liridone I. Durmishi; 'algroup.pro.shpk@gmail.com'
Subject: FW: Kërkesë për skicën e raftave – ne barnatoren e QMF Komoran

I nderuar,

Gjatë takimit të mbajtur me datë 24.10.2025 ne mes projektuesit(algroup),operatorit(Katrorigroup) Drejtoreshes DSHMS menaxherit kontrates, „Zyres prokurimit,dhe urbanzmit,pas dakordimit të gjithve qe deri sa te sqarohet me skicë nga ana e projektuesit te mos fillohet me punime,

Ju kërkoj që deri në kthimin e përgjigjes nga projektuesi,kërkoj që te mos fillohet asnje punim ne terren,Pas pranimit të përgjigjes zyrtare, nga ana e projektuesit,do tju njoftoj menjehere me fillimin e punimeve,
Deri me tani nuk ka kthyer asnjë përgjigje me email zyratar,

From: Armend Kurtaj
Sent: Friday, October 24, 2025 3:40 PM
To: 'algroup.pro.shpk@gmail.com' <algroup.pro.shpk@gmail.com>
Cc: Lumturije Kiqina <Lumturije.Kiqina@rks-gov.net>; Lumnije O. Krapë <Lumnije.O.Krapi@rks-gov.net>; Liridone I. Durmishi <Liridone.I.Durmishi@rks-gov.net>; Gentiana Qela <Gentiana.Qela@rks-gov.net>
Subject: Kërkesë për skicën e raftave – ne barnatoren e QMF Komoran

I nderuar

Ju lutem, më dërgoni skicën zyrtare për vendosjen e raftave në barnatoren e QMF Komoran, në mënyrë që të kem dokumentin për orientim të saktë gjatë zbatimit të punimeve.

Deri tani nuk kam pranuar asnjë skicë në dokumentacionin që posedoj, prandaj kërkoj që të ma dërgoni me email sa më pare, qe operatori te filloj me punime.

Faleminderit për bashkëpunim.

Armend Kurtaj – Zyrtar për Politika të Banimit
Komuna Drenas
Telefon: +383 044 833 088
Email: Armend.Kurtaj@rks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit




01 Nr 400/01-4530 dt. 15/11 2025

Në vështrim të nenit 13, 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 81 të Ligjit 04/-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 70 pika 70.23 dhe 70.24 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (i hyrë në fuqi me 01.11.2022), nenit 70 pika 70.25 Ndryshim Plotësim i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik i datës 11.11.24, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 49 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M

- I. Emërohet **Armend Kurtaj** për menaxhimin e kontratës me titull “Furnizimi me rafta për barnatoren e QMF-Komoran”, me numër të prokurimit identifikues: 611-25-5350-1-3-6 datë 08.10.2025, me nr të Arhivit, 400/01-44450 që e kryen “OE Katrori Group sh.p.k,rr.Lidhja e Prizrenit 197 nr.32,Prishtinë.
- II. Përgjegjësitë e menaxherit të kontratës se lartcekur janë:
Menaxheri i kontratës do të menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
Sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë dhe
Bëj **vlerësimin e përformancës së kontraktuesve** për kontratat nën menaxhimin e tij. Ndërsa funksionet e menaxherit të projektit janë obligimet e parapara me normat e nenit 70.24 me nënparagrafet duke filluar nga germa (a) deri tek ajo (k) të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (i hyrë në fuqi me 01.11.2022).
- III. Të lëshojë Certifikatat e nënshkuara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).
- IV. Menaxheri i emëruar sipas pikës I të këtij vendimi, punën e tij duhet ta kryej me profesionalizëm të lartë, si dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Prokurimit;
- Njësisë kërkuese;
- Menaxherit të Kontratës;
- Operatorit Ekonomik;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.

Per ; KOMUNA GLLOGOC

Ne KATRORI GROUP SH.P.K., Rr. Lidhja e Prizrenit Hy 197 Nr 32, Prishtinë;\

Furnizimi ne rafta per barnatoren e QMF-Komoran

611-25-5350-1-3-6

Totali I I pozicionit 2.2 ne vend te 2850 e pranojme korigjimin 2800 euro

E pranojme korigjimin e çmimit nga ana juaj pajtohem me totalin e pergjithshem e ofertes ne vlere prej ; 3,405.00 euro

Katrori Group Shpk





REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/municipality Drenas/Glllogoc/
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale



date 03.06.2025

Arsyet e Kërkesës: Furnizimi me rafta për barnatoren e QMF-Komoran

Nr.	ARTIKUJT	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	-
				i përfaqërt	Shuma e përfaqërt
1	Furnizimi me rafta per barnatore-QMF Komoran			4,000.00	4,000.00
2					
3					
4					-
5					-
	Totali				4,000.00

Bilanci / Mbetja e buxhetit

Kategoria ekonomike e shpenzimit-(mallra&sherb)-(komunali)-(Invest.Kapitale)-Subvencione)

Kodi ekonomik _____

Zyrtari i prokurimit _____

Autorizuesi: Lumnije Krapë, Drejtore DSHMS

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR 03/06/2025			
Nj. Org.	Numër	Shtojcë	Vlera
06	400/01-20406		



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
 Drejtoria për Shendetësi dhe Mirëqenie
 Sociale



Data	03.06.2025
Nga:	Drejtoria e Shendetësisë dhe Mirëqenies Sociale, znj.Lumnije Krapit
Për:	Zyra e Prokurimit
Lënda:	Kërkesë për "Furnizimi me rafta për barnatoren e QMF-Komoran"

Kërkojmë nga Zyra e Prokurimit që në harmoni me ligjet në fuqi të fillohet me iniciimin procedurave të nevojshme për shpalljen e tenderit , me titull:

" Furnizimi me rafta për barnatoren e QMF-Komoran"

Shkresës ia bashkangjesim:

Kërkesën

Paramasën dhe

Deklaratën e nevojave

Me respekt!

KOMUNA E DRENAS-IT

Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve
Sipas Nenit 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i
ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.
05/L-092

Data

02/06/2025

E rezervuar për AQP

Data e pranimi

Identifikuesi

Nr. i Prokurimit:

NENI I: IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK	KOMUNA DRENAS	Personi kontaktues e-mail:	Lumnije Krapi Lumnije.o.krapi@rks-gov.net
Adresa	"F. E XHEVË. LLADROVCI"	Kodi postar	13000
Qyteti	DRENAS	Regjioni	PRISHTINË
Telefoni	038 20040889	Faksi	
e-mail:		URL:	

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1. VLERËSIMI I NEVOJAVE

II.1.1 Klasifikimi (FPP):

II.1.2 Natyra dhe fushëveprimi.

" Furnizimi me rafta për barnatoren e QMF-Komoran "

II.1.3 Vlera e parashikuar:

4000 Euro

II.1.4 Kushtet Materiale:

Lënda e kësaj kontrate është: "
" Furnizimi me rafta për barnatoren e QMF-Komoran "

II.1.5 Specifikacionet funksionale, përfitimet dhe kostot: Referoju Aneksit I të bashkangjitur.

II.1.6 Planifikimi:

KOMUNA GLLOGOC

PLANI PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS

Sipas Nenit 81.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92

Data e përgatitjes së PMK: 16.10.2025

Përgatitur nga:

Informacion mbi kontratën:

Kontrata No.: 611-25-5350-1-3-6/C882

Emri dhe adresa e operatorit ekonomik: KATRONI GROUP SH.P.K., Rr. Lidhja e Prizrenit Hy 197
Nr 32, Prishtinë

Data e nënshkrimit: 08.10.2025

Vlera (me TVSH): 3,405.00 EUR

Procedura e prokurimeve

Numri i Prokurimit	611-25-5350-1-3-6	
Titulli i Kontratës	Furnizimi ne rafta per barnatoren e QMF-Komoran	
Punë/Shërbime/Furnizime	Viti Buxhetor	Emri dhe mbiemri i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit
☐ Punë ☐ Shërbime ☒ Furnizime	2025	Gentiana Qela

Ngjarjet/Rezultatet e Kontratës	DETAJET E IMPLEMENTIMIT [Afatet, Sasitë/Shumat]
Pjesët nën 'Detajet e Implementimit' në <i>italike</i> duhet të kompletohen dhe të bien dakord në mesë të palëve të kontratës para inicimit të implementimit të kontratës. PMK duhet të përtërihet gjatë implementimit të kontratës. Vendosi Nuk Aplikohet për ato që nuk janë relevante	
I. Fillimi/ Mobilizimi i Kontratës	
Njoftimi për fillimin e punës/shërbimeve/furnizimit të mallrave	17.10.2025
Afati i përmbushjes	20.11.2025
Pranimi i garancisë së performancës dhe lirimi i sigurimit të tenderit	Sigurimi i tenderit u kthye në . Garancia e performancës në vlerë prej EUR është marrë në dhe ka vlefshmëri deri më .

Pranimi i garancisë së pagesës në avans, nëse është e aplikueshme	Garancia e pagesës në avans në vlerë prej EUR është marrë në .			
Pagesa e avansit , nëse është e aplikueshme	Pagesa e avansit në vlerë prej EUR është paguar më .			
Shuma e dëmeve të likuiduara përfshirë kufizimin e dëmeve të likuiduara				
Periudha e përgjegjësisë për defekte				
II. Progresi i Kontratës				
Dorëzimet e Mëtitjeshme Shërbimet: raportet e progresit etj. Furnizimet: liferimi i dytë etj. Punët: instalimi i dytë etj.	No.	Dorëzimet	Vlerë	Data e planifikuar e dorëzimit
	1	Situacioni i pare		20.11.2025
Bisedimet e Rregullta, nëse është e aplikueshme	Sipas nevojës nga menaxheri i kontratës			
Inspektimi i punëtorëve, materialeve dhe vendeve të prodhimit	Nga menaxheri i kontratës dhe komisioni i pranimit teknik			
Pagesat e përkohshme apo në fazë, nëse është e aplikueshme	Pas dorëzimit të situacioneve dhe pas pranimit teknik			
Reduktimi i garancive, nëse është e aplikueshme				
III. Përmbyllja e Kontratës				
Pranimi/ dorëzimi	20.11.2025			
Pagesa e Fundit	Deri me datë 25.11.2025 në vlerën e realizuar të kontratës			
Fondet e mbajtura				
Skadimi i garancionit/periudha e përgjegjësisë				


Lirimi i garancisë	
--------------------	--


Finalizimi i Planit të Menaxhimit të Kontratës

Në emër të KOMUNA GLLOGOC
Menaxheri i Projektit

Në emër të KATRORI GROUP SH.P.K.
Menaxheri i Projektit

Blerina Gashi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
611-25-5350-1-3-6/C882



K O N T R A T Ë / FURNIZIM

Emri i Projektit: **Furnizimi ne rafta per barnatoren e QMF-Komoran**

Numri identifikues : 611-25-5350-1-3-6 ,Datë: 08.10.2025; Nr. i arkivit; 400-01/- 44430

PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT , përfaqësuar nga **GENTIANA QELA** Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënësi").

KATRORI GROUP SH.P.K., Rr. Lidhja e Prizrenit Hy 197 Nr 32, Prishtinë, përfaqësuar nga **BLERINA GASHI** , Drejtor (më tutje kontraktuese).

Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **Furnizimi ne rafta per barnatoren e QMF-Komoran**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të furnizimeve do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹. Periudha e kryesjes së punëve/shërbimeve dhe furnizimeve do të jetë deri në afatin : 30 dite

Neni 3 Çmimi

3 Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: **3,405.00 €**; [Tremijë e Katerëqindë e Pesë euro

4 3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton menaxherit te projektit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të

Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktot me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Krytari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranim i caktojnë Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së **furnizimeve** duhet të jetë brenda 10 dite. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen DREJTORIA E SHENDETSIS

-se.

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **furnizimeve** të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **furnizimeve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimi, urdhërit për pagesë dhe urdhërbljes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve/shërbimeve/punëve** duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit, dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Krytari i Komunes.

Neni 7 Garancioni i shërbimeve]

7.1 Garancioni nuk kërkohej.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përpunimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shratë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dëkujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.



13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës, Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me menjëherë pas nënshkrimit.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GENTIANA QELA	Emri:	BLERINA GASHI
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.10.2025	Data:	08.10.2025
Vula:		Vula:	